

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/4984/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Hib Petrol" Sh.p.k., Talinoc i Muhagjerëve, Ferizaj Stacion i Karburanteve, Vushtrri
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore të operatorit "HIB Petrol" Sh.p.k., Talinoc i Muhagjerëve, Ferizaj, me nr. prot. 24/4984/ MMPHI, Stacion i Karburanteve Vushtri.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/4989/MMPHI
Datë: 17.10.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Hib Petrol" Sh.p.k.Talinoc i Muhagjerëve, Ferizaj, me nr. prot.24/4984/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Stacion i Karburanteve, Vushtrri, në ngastrën nr. 01395-1, për rezervuarët me kapacitet si në vijim: V=1x 60.000 (40. 000L për dizel dhe 20.000L për Shell) dhe 1x30.000 (20.000L për benzinë dhe 10.000L Power).
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen dhe të kontrollohen basenet për trajtimin-sedimentimit të vajrave nga shkarkimi i ujërave nga plateja e sipërfaqes së operimit;
 - 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit;



- 2.4. Të kontrollohen në vazhdim kolektorët për grumbullimin e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e operimit -stacionit të karburantit, nga mbushja me sediment;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 2.6. Të monitorohet në vazhdim emisionet në ujë dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Hib Petrol" Sh.p.k., Talinoc i Muhagjerëve, Ferizaj, me nr. prot. 24/4984/MMPHI, për veprimtarinë: Stacion i Karburanteve, Vushtrri, në ngastrën nr.01395-1, për rezervuaret me kapacitet si në vijim: V=1x 60.000 (40. 000L për dizel dhe 20.000L për Shell) dhe 1x30.000 (20.000L për benzinë dhe 10.000L Power), është konstatuar se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 23/4039/1-ZSP/23, të lëshuar me datë: 31.10.2023;
- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent- AME me nr. 0002791/23, të lëshuar me datë:15.09.2023;
- Leje ndërtimore nga Komuna, Nr.686/23, data e lëshimit: 08.12.2023.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike, mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Vushtrri;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së